

# Njoftim privatësie për klientët e Jaguar Land Rover dhe pranuesit e shërbimeve për në raste defektesh

## Njoftim privatësie

### Ne kujdesemi për të dhënat tuaja personale

**AWP SERVICES NL B.V.**, (“ne”, “neve”, “tonat”), që operon nën markën “Allianz Global Assistance Europe”, është kompani e grupit Allianz Partners, e themeluar sipas ligjeve të Hollandës. Mbrojtja e të dhënave tuaja është prioriteti ynë absolut. Ky njoftim privatësie shpjegon llojet e të dhënave personale që mblidhen, mënyrën si mblidhen ato, pse dhe kujt i përcillen ose shpalosen. Ju lutemi, lexojeni me kujdes këtë njoftim.

#### 1. Kush është kontrolluesi i të dhënave?

Kontrollues i të dhënave është individi ose personi juridik që kontrollon dhe është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale, në format të shtypur ose elektronik.

**AWP SERVICES NL B.V.**, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e të dhënave, është kontrolluesi i të dhënave personale që i kërkojmë dhe mbledhim nga ju për qëllimet e paraqitura në këtë njoftim privatësie.

#### 2. Cilat të dhëna personale mblidhen?

Nëse na kontaktoni për të kërkuar ndonjë prej shërbimeve tona për ndihmë në rrugë në rast defekti, ne ju kërkojmë të dhënat personale në vijim:

- Emrin, mbiemrin
- Numrin e targës së automjetit
- Numrat e telefonit
- Adresën e emailit
- Vendin ku kërkohet ndihma
- Mesazhin me zë, nëse telefonata juaj është regjistruar.

me rastin e ofrimit të ndihmës në rast defekti, mund t’ju kërkojmë informacione shtesë që mund të konsiderohen të dhëna ose informacione personale. Për shembull, mund t’ju kërkojmë adresën e shtëpisë nëse duhet të merremi me kthimin tuaj aty, mund të kërkojmë edhe informacione për personat e tjerë që udhëtojnë me ju dhe që mund të jetë përfitues të shërbimeve.

 **Kur na jepni të dhëna personale të personave të tjerë që mund të jenë përfitues të shërbimeve, ju merrni përsipër t’u përcillni atyre informacionet që përfshihen në këtë njoftim privatësie dhe pajtoheni që këtë informacion të mos e shpërndani në raste të tjera.**

### 3. Si i marrim dhe si i përdorim të dhënat tuaja personale?

Ne do të mbledhim dhe përdorim të dhënat personale që na jepni dhe që ne i marrim për ju (siç shpjegohet më poshtë) për një numër arsyesh dhe me pëlqimin tuaj të shprehur, përveç nëse kjo e fundit nuk kërkohet nga ligjet dhe rregulloret në fuqi, siç tregohet në këtë tabelë:

Qëllimi	A na duhet pëlqimi juaj i shprehur?
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të ofruar shërbime të ndihmës në rrugë në rast defekti, të listuara në termat dhe kushtet e marrëveshjes së shërbimeve në mes Jaguar Land Rover (kontraktori) dhe Allianz Global Assistance Europe (ofruesi i shërbimeve), që do t'u ofrohen klientëve (pranuesit) përfundimtarë të Jaguar Land Rover.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të dhënat tuaja do t'i përpunojmë për të përmbushur obligimet tona ndaj jush sipas marrëveshjes së shërbimeve të përmendur më lart dhe siç parashihet sipas të drejtës civile dhe tregtare, në interesin legjitim të të dyja palëve dhe interesin tuaj si pranues i shërbimeve.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për ta faturuar Jaguar Land Rover në këmbim të pagesave që ju bëjmë juve, kur kërkohet sipas termave të marrëveshjes së shërbimeve të përmendur më lart.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpunimi i të dhënave tuaja për këto qëllime është i nevojshëm për ne, Allianz Global Assistance Europe, për të ushtruar të drejtat tona ndaj Jaguar Land Rover dhe që Jaguar Land Rover të përmbushë obligimet e saj të parapara në marrëveshjen e lidhur në mes dy palëve.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për t'i ofruar informacione Jaguar Land Rover me qëllim të monitorimit të obligimeve të Allianz Global Assistance Europe, siç përcaktohet në marrëveshjen e shërbimeve, për të siguruar që ato të kryhen mirë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo, për aq sa këto aktivitete përpunimi përfaqësojnë interes legjitim të Jaguar Land Rover si kontraktues.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të ndarë detajet tuaja të kontaktit me Jaguar Land Rover ose me një palë të tretë që vepron në emër të saj, për t'ju kontaktuar me qëllim të realizimit të anketave të hulumtimit të cilësisë së shërbimeve që ofrojmë, për të përcaktuar sa jeni të kënaqur dhe për ta përmirësuar përvojën tuaj si klient.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo, bazuar në interesin legjitim të Jaguar Land Rover për të verifikuar në mënyrë të pavarur cilësinë e shërbimeve të saj dhe interesin legjitim të Allianz Global Assistance Europe për të verifikuar pajtueshmërinë me standardet e cilësisë të Jaguar Land Rover.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për t'u mbrojtur ndaj ankesave ose mosmarrëveshjeve ligjore që mund të iniciohen nga Jaguar Land Rover ose pranuesit e shërbimeve të saj, për pretendime për detyrime kontraktuale ose detyrime të palëve të treta në lidhje me shërbimet e ofruara nga Allianz Global Assistance Europe ose punonjësit tanë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo. Në bazë të interesit tonë legjitim të mbrojtjes, kemi të drejtën të përpunojmë të gjitha të dhënat që na jepni, e të cilat janë adekuate, relevante dhe nuk shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të përmbushur këto qëllime.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të kryer analiza statistikore dhe cilësore bazuar në të dhënat e grumbulluara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të gjitha aktivitetet që kryejmë përdorim të dhëna të grumbulluara dhe të anonizuara. Pas këtij procesi, të dhënat nuk konsiderohen më të dhëna personale dhe pëlqimi juaj nuk kërkohet.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të përmbushur detyrimet ligjore (për shembull, ato që dalin nga ligjet për kontratat sipas të drejtës civile dhe tregtare, shërbimet për ndihmë në rrugë në rast prishje, rregulloret për tatimin, kontabilitetin dhe ato administrative, për të parandaluar pastrimin e parave dhe për qëllime verifikimi të sanksioneve, d.m.th për të vlerësuar nëse ju, vendi juaj ose sektori juaj i biznesit i nënshtrohet sanksioneve që mund ta parandalojnë ose kufizojnë mundësinë tonë për të bërë biznes, siç është kryerja e pagesave).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo; për aq sa këto aktivitete përpunimi janë të autorizuara shprehimisht ose kërkohen sipas ligjit, ne kemi të drejtën të përpunojmë të dhënat tuaja personale për këto qëllime dhe të mbajmë dokumentacionin e nevojshëm, pa kurrfarë detyrimi për të marrë pëlqimin tuaj.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Parandalimi dhe hetimi i mashtrimit, përfshirë, nëse është e nevojshme, krahasimin e të dhënave tuaja me kërkesat e mëparshme për shërbime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jo. Kuptohet se hetimi dhe parandalimi i mashtrimit është interes legjitim i kontrolluesit të të dhënave. Për këtë arsye, ne kemi të drejtë të përpunojmë të dhënat tuaja pa marrë pëlqimin tuaj.</li> </ul>

Qëllimi	A na duhet pëlqimi juaj i shprehur?
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për qëllime auditimi, për të përmbushur detyrimet ligjore ose udhëzimet e brendshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ne mund të përpunojmë të dhënat tuaja në kuadër të auditimeve tona të brendshme ose të jashtme që kërkohen me ligj ose nga udhëzimet tona të brendshme, ose që kërkohen nga Jaguar Land Rover si pjesë e marrëveshjes së shërbimeve, në të cilën ju jeni përfitues. Nuk do të marrim pëlqimin tuaj për këto aktivitete përpunimi, për aq sa ato janë të autorizuara nga rregulloret në fuqi ose interesat legjitime të Allianz Global Assistance Europe ose Jaguar Land Rover. Megjithatë, do të sigurohemi që të përdorim vetëm ato të dhëna tuaja që janë absolutisht të nevojshme dhe ato do të trajtohen me konfidencialitet të plotë.</li> </ul> <p>Auditimet e brendshme të Allianz Global Assistance Europe në përgjithësi kryhen nga kompania jonë mëmë Allianz Partners SAS (Rr. Dora Maar 7, 93400 Saint-Ouen, Francë).</p>

Të dhënat që synohet të përdoren për qëllimet e lartpërmendura mund t'i marrim drejtpërdrejt nga ju, nga pranuesi i shërbimeve me të cilin udhëtoni, apo edhe nga ofruesit tanë të autorizuar nga ne për ofrimin e shërbimeve.

Të dhënat tuaja personale na nevojiten nëse doni të përfitoni shërbimet që Jaguar Land Rover na ka autorizuar t'ju ofrojmë klientëve të saj. Nëse nuk dëshironi të na jepni informacionet e kërkuara, nuk mund t'ju garantojmë ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e kërkuar nga ne.

#### 4. Kush do të ketë qasje në të dhënat tuaja personale?

Do të sigurojmë që punonjësit tanë të përpunojnë në mënyrë konfidenciale të dhënat tuaja personale, vetëm për aq sa janë të nevojshme dhe në përputhje me qëllimet e cekura më lart.

Për të përmbushur qëllimet më lart, të dhënat tuaja mund të bashkëndahen me personat në vijim, që veprojnë si kontrollues të dhënash palë e tretë:

autoritetet qeveritare, kompani të tjera Allianz Partners dhe të grupit Allianz (për shembull për qëllime vlerësimi), palë të treta, punonjës dhe partnerë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve (për shembull shoferë ose ofrues ndihme në rrugë, agjenci udhëtimesh, linja ajrore, kompani të taksive, punëtori riparimi, hetues për parandalimin e mashtrimit, avokatë), ekspertë të pavarur etj.

Aty ku ceket në këtë njoftim privatësie, mund të bashkëndajmë të dhënat tuaja personale me Jaguar Land Rover, në pajtim me rolin e saj si kontraktuese e shërbimeve që ju përfitoni.

Për qëllimet e përmendura më lart, mund të bashkëndajmë të dhënat tuaja personale me palët e treta në vijim, që veprojnë si përpunues të dhënash, që do të thotë se ata përpunojnë të dhënat në pajtim me udhëzimet tona dhe i nënshtrohen të njëjtave detyrime lidhur me konfidencialitetin, fushëveprimin e nevojshëm të përpunimit dhe pajtueshmërisë me qëllimet e specifikuar në këtë njoftim privatësie.

Kompanitë e tjera Allianz Partners ose të grupit Allianz ose palët e treta që veprojnë si nënkontraktues për procese të brendshme të kompanisë (p.sh. kompanitë e tjera të Alliance Partners Group, që veprojnë si nënkontraktues për Allianz Global Assistance Europe dhe ofrojnë shërbime në vendet e përfshira në marrëveshjen e shërbimeve në mes Jaguar Land Rover dhe Allianz Global Assistance Europe, kompanitë e grupit ALLIANZ TECHNOLOGY, që ofrojnë mbështetje dhe mirëmbajtje lidhur me teknologjinë e informacionit (TI), ofruesit e tjerë të TI-së, konsulentët e tatimeve, ofruesit e shërbimeve të postës dhe menaxhimit të dokumenteve), konsulentët teknikë, ekspertët e fushës (TI, postë, menaxhim i dokumenteve)

Së fundi, mund të ndajmë të dhënat tuaja personale me palë të treta në këto raste:

- në rast të riorganizimit të kompanisë, shkrirjes, shitjes, sipërmarrjes së përbashkët, caktimit, transferimit ose riorganizimeve të tjera, qoftë të synuara apo aktuale, të tërë ose një pjesë të biznesit tonë, aseteve ose aksioneve tona (përfshi procedurat e falimentimit ose të ngjashme); dhe

- për të përmbushur detyrimet ligjore, përfshirë detyrimin karshi autoriteteve rregullore përkatëse (Avokati i Popullit), nëse paraqitni ankesë rreth produktit ose shërbimit që ju kemi ofruar.

## 5. Ku do të përpunohen të dhënat e mia personale?

Të dhënat tuaja personale mund të përpunohen brenda ose jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) nga palët e specifikuar në seksionin 4 më sipër, gjithmonë në varësi të kufizimeve kontraktuale lidhur me konfidencialitetin dhe sigurinë, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Të dhënat tuaja nuk do t'i ndajmë me palë të treta që nuk janë të autorizuara për përpunimin e tyre.

Sa herë që transferojmë të dhënat tuaja personale jashtë ZEE-së për përpunim nga një kompani tjetër e grupit Allianz, këtë e bëjmë në bazë të rregullave të brendshme të miratuara nga Allianz, që njihen me emrin Allianz Privacy Standard (Standardi i Allianz për Privatësinë (BCR)), që garanton një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes për të dhënat personale dhe që është i detyrueshëm ligjërisht për të gjitha kompanitë e grupit Allianz. [Këtu](#) mund ta gjeni Standardin BCR të Allianz dhe listën e kompanive të grupit Allianz që iu përbahen atyre. Në rast se BCR-ja e Allianz nuk aplikohet, ne do të ndërmarrim masa për të siguruar që të dhënat personale që transferohen jashtë ZEE-së, të kenë nivelin e duhur të mbrojtjes sikur në ZEE. Për të mësuar për masat e mbrojtjes që ne zbatojmë në raste të transferimeve të tilla (si klauzolat kontraktuale standarde), ndihuni të lirë të na kontaktoni sipas udhëzimeve në seksionin 9 më poshtë.

## 6. Cilat janë të drejtat tuaja sa i përket të dhënave tuaja personale?

Kur lejohet sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe brenda fushëveprimit të përkufizuar aty, ju keni të drejtë:

- të keni qasje në të dhënat tuaja personale të mbajtura për ju dhe të mësoni më shumë për origjinën e të dhënave, qëllimet e përpunimit, informacionet për kontrolluesin(it) e të dhënave, përpunuesin(t) e të dhënave dhe palët me të cilët të dhënat mund të jenë ndarë;
- të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë nëse të dhënat tuaja personale përpunohen me pëlqimin tuaj;
- të përditësoni ose korrigjoni të dhënat tuaja personale që ato të jenë gjithmonë të sakta;
- të fshini të dhënat tuaja personale nga shënimet tona nëse ato nuk nevojitem më për qëllimet e përmendura më sipër;
- të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në rrethana të caktuara, p.sh. nëse keni kontestuar saktësinë e të dhënave tuaja personale gjatë një periudhe të caktuar kur ne mund të shqyrtojmë saktësinë e të dhënave;
- të merrni të dhënat tuaja personale në format elektronik për ju dhe kompaninë tuaj të re të sigurimit; dhe
- të paraqitni ankesë tek ne dhe/ose autoritetet për mbrojtjen e të dhënave.

Këto të drejta mund t'i ushtroni duke na kontaktuar, siç shpjegohet në detaje në seksionin 9 më poshtë, dhe duke na treguar emrin, adresën e emailit, numrin e llogarisë dhe qëllimin e kërkesës suaj.

## 7. Si mund ta kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja?

Kur lejohet sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale ose të na kërkonti të ndalojmë përpunimin e mëtejshëm (përfshirë përpunimin për qëllime të marketingut direkt). Pasi të na keni përcjellur kërkesën tuaj, ne nuk do të vazhdojmë më përpunimin e të dhënave tuaja personale, përveç nëse kjo lejohet sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Mund të ushtroni këtë të drejtë ashtu siç do të ushtronit të drejtat e tjera të specifikuar në seksionin 6 më sipër.

## 8. Për sa kohë i mbajmë të dhënat tuaja personale?

Të dhënat tuaja personale do t'i mbajmë për aq sa të jetë e nevojshme për qëllimet e paraqitura në këtë njoftim privatësie dhe do t'i fshijmë ose anonimizojmë kur të mos na nevojiten më. Më poshtë mund të gjeni detaje për periudhat e mbajtjes së të dhënave, të cilat aplikohen për qëllimet e paraqitura në seksionin 3 më sipër.

Megjithatë, ju lutemi, vini re se kohë pas kohe, kërkesa ose ngjarje të reja mund t'i shfuqizojnë këtë periudha të mbajtjes së të dhënave, për shembull në rast të proceseve ligjore të vazhdueshme që lidhen me informacionet përkatëse ose mosmarrëveshjet ligjore të pazgjidhura, të cilat mund të pezullojnë ose anulojnë këto periudha mbajtjeje derisa çështja të zgjidhet dhe periudha korresponduese e dhënë për shqyrtim ose apel të ketë përfunduar. Në veçanti, periudhat e mbajtjes bazuar në statute kufizimi për kërkesa ligjore mund të pezullohen dhe pastaj të riaktivizohen në një datë të mëtejme.

Të dhënat personale të mbledhura gjatë rrjedhës së kërkesave tuaja për ndihmë brenda fushëveprimit të marrëveshjes së shërbimeve të lidhur në mes Allianz Global Assistance Europe dhe Jaguar Land Rover.	Ne do t'i ruajmë të dhënat personale që na jepni për aq kohë sa të jetë e përshtatshme, relevante dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme në lidhje me qëllimet e paraqitura në seksionin 3 më sipër.
---	--

	<p>Në veçanti, do të përpunojmë të dhënat tuaja personale gjatë dhe pas ofrimit të shërbimeve të kërkuara nga ju brenda fushëveprimit të marrëveshjes korresponduese të shërbimeve, për aq sa të jetë e nevojshme për të marrë informacionet që Jaguar Land Rover, si kontraktues, duhet t'i ofrojë Allianz Global Assistance Europe për monitorimin e përbushjes së obligimeve tona kontraktuale (për shembull, përbushjen e shërbimeve të dakorduara me kontratë në pajtim me termet dhe kushtet e dakorduara, pajtueshmërinë me marrëveshjen e nivelit të shërbimit dhe treguesit kyç të performancës etj.).</p> <p>Gjithashtu, kemi të drejtën të ruajmë të dhënat tuaja personale gjatë periudhave të kufizimit të paraqitura sipas rregulloreve në fuqi, që të mund të dorëzojmë një kërkesë të mundshme ose potenciale për detyrim kontraktual ose kërkesë për detyrim të një pale të tretë për t'u mbrojtur ndaj kërkesave të tilla, ose për të pretenduar të drejtat tona karshi jush, Jaguar Land Rover ose ndonje pale tjetër të përfshirë.</p>
<p>Të dhënat personale që mund të përfshihen në faturat e lëshuara për riimbursim të disa shumave nga Jaguar Land Rover, të cilat, me ju si pranues i shërbimeve, mund t'i presim brenda fushëveprimit të marrëveshjes ose në ndonjë dokumentacion tjetër që lidhet me këto fatura.</p>	<p>Këtë informacion do ta përpunojmë për aq sa të jetë e nevojshme për ta kryer pagesën e shumave përkatëse, si dhe për ato periudha në rastet kur rregulloret për kontabilitet e autorizojnë ruajtjen e dokumentacionit të procesit të transaksionit në regjistrat përkatës të kontabilitetit.</p>
<p>Informacionet e kontaktit për anketat e Jaguar Land Rover për cilësinë.</p>	<p>Informacionet tuaja të kontaktit do t'i përpunojmë për aq sa të jetë e nevojshme për t'ia verifikuar JLR-së se në këtë drejtim ne i kemi përbushur obligimet tona kontraktuale në marrëveshjen e shërbimeve dhe në pajtim me ligjin gjerman, që qeveris këtë marrëveshje.</p>
<p>Të dhënat personale që kërkohen për përbushjen, ose verifikimin e pajtueshmërisë me obligime ligjore (për shembull, ato që dalin nga ligjet që qeverisin kontratat sipas të drejtës civile dhe tregtare, ato që kanë të bëjnë me aktivitete lidhur me shërbimet për prishje, ose rregulloret tatimore, kontabilitetin dhe obligimet administrative për të parandaluar pastrimin e parave ose për qëllime të verifikimit të sanksioneve, pra vlerësimin nëse ju, vendi juaj apo sektori juaj i biznesit i nënshtrohet sanksioneve që mund ta parandalojnë ose kufizojnë mundësinë tonë për të bërë biznes, siç është kryerja e pagesave etj.).</p>	<p>Ne do të përpunojmë të dhënat tuaja personale nëse kjo është e përshtatshme, relevante dhe nuk shkon përtej asaj që nevojitet për këto qëllime, për ato periudha të lejuara nga rregulloret përkatëse në fuqi.</p>
<p>Të dhënat personale të përfshira në dokumente që mbështesin çfarëdo lloj mashtrimi.</p>	<p>Këto informacione do t'i ruajmë për aq sa neve na duhet për të parandaluar përpjekjet e reja për mashtrim, përveç nëse informacionet pasuese ose shtesë që ne pranojmë, ose të cilat na ofroni, mbështesin pasaktësinë e këtij informacioni.</p>

Ne nuk do t'i ruajmë informacionet tuaja personale më gjatë sesa duhet dhe do t'i përdorim ato për qëllimet për të cilat janë mbledhur.

## 9. Si mund të na kontaktoni?

Nëse keni pyetje lidhur me përdorimin e të dhënave tuaja personale, mund të na kontaktoni në emailin ose postën e rregullt në vijim:

**AWP SERVICES NL B.V.**

Attn: Data Protection

**Poeldijkstraat 4 – 1059 VM – Amsterdam – Netherlands**

Email: [dataprivacy.fos.sk@allianz.com](mailto:dataprivacy.fos.sk@allianz.com)

Të njëjtat detaje kontakti mund t'i përdorni edhe për të ushtruar të drejtat tuaja ose për t'i përcjellë pyetjet ose shqetësimet tuaja te kompanitë e tjera Allianz Partners që veprojnë si kontrollues të dhënash (shih seksionin 4 më sipër) dhe me të cilët ka mund të kemi bashkëndarë të dhënat tuaja personale. Pyetjet tuaja do t'ju përcjellim atyre dhe do t'i ndihmojmë në gjuhën tonë të përpunojnë dhe t'i përgjigjen shqetësimeve tuaja.

## 10. Sa shpesh e përditësojmë këtë njoftim privatësie?

Këtë njoftim privatësie e rishikojmë rregullisht. Përditësimi i fundit është bërë në **shtator 2019**.